



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. **141**

Prishtinë, më 18.3.2014, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Faton Topalli, Rasim Demiri, Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri, Salih Morina, Ramiz Lladrovci, Nijazi Idrizi, Boban Todorović.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: sipas listës së nënshkruar nga pjesëmarrësit.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës ;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 4.3.2014,
3. Shqyrtimi i Projektligjit për mbrojtjen nga zhurma,
4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 4.3.2014

Kryetari i Komisionit konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur me 4 mars 2014.

3. Shqyrtimi i projektligjit për mbrojtjen nga zhurma

Kryetari Nait Hasani përshëndeti ministrin **Dardan Gashi** dhe ekipin e tij, para se të filloi me shqyrtimin e projektligjit rikujtoi të pranishmit që vërejtjet për projektligjin duhet të dërgohen me shkrim në afatin e caktuar nga komisioni, përndryshe mund të mbesin pa u shqyrtuar, siç janë këto të fundit nga OSCE të cilat kanë arritur pak para se me fillu mbledhja e sotme i komisionit. Sikurse edhe sfidat tjera në këtë komision me projektligje, vazhdoi kryetari, edhe kjo sfidë do të përfundoi me sukses, ngase komisioni është përkujdes që të eliminohen dilemat duke bërë vizitat e duhura si jasht vendit (Stamboll dhe Ankare) ashtu edhe brenda (në Prizren), përveç në Graçanicë ku kisha ortodokse është njoftuar përmes anëtarit të komisionit-Todoroviq, por nuk është interesuar për takim. Ndërhyri **ministri Gashi** dhe shtoi se edhe Prifti Teodosije është njoftuar dhe është pajtuar me propozimet e MMPH për këtë projektligj, përndryshe ministri potencoi se sugjerimet e sotme nga MMPH janë të harmonizuara me BIK por edhe me bashkësit tjera fetare (janë mar parasysh edhe vërejtjet e kishës katolike).

Komisioni shqyrtoi dhe miratoi amendamentet në vazhdim, por mbetet që në takimin e radhës të sjellën edhe disa propozime nga MMPH rreth gjobave.

Amendamenti 1

Neni 1, Paragrafi 1, riformulohet si vijon:

Ky ligj ka për qëllim mbrojtjen e shëndetit dhe të mjedisit nga zhurmat, duke përcaktuar mënyrën e shmangies dhe masat për parandalimin, reduktimin dhe zhdukjen e efekteve të dëmshme të ekspozimit ndaj tyre, përfshirë bezdinë nga zhurma. Ky Ligj është në përputhshmëri me Direktivën e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, për vlerësimin dhe menaxhimin e zhurmës mjedisore (Direktiva nr.2002/49/EC).

Amendamenti 2

Neni 3, riformulohen paragrafet si vijon:

Paragrafi 1.1. **"Zhurmë mjedisore"** është çdo tingull, i padëshiruar apo i dëmshëm, i lëshuar nga veprimtaritë njerëzore, përfshirë zhurmën e lëshuar nga mjetet e transportit, nga trafiku rrugor, hekurudhor, ajror dhe nga sheshet ku zhvillohen veprimtari industriale, të cilat janë objekt i këtij ligji.

Paragrafi 1.4. "Burim zhurme" është çdo makinë, instalim, mjet pune, mjet transporti, proces teknologjik, aparat elektroakustik, që lëshon zhurmë, njësitë e objekteve të lëvizshme ose të palëvizshme dhe veprimtaritë sportive dhe argëtuese.

Paragrafi 1.6. **"Vlerësim"** është mënyra e përdorur, për të llogaritur, parashikuar, vlerësuar apo matur vlerën e indikatorit të zhurmës ose efektet e dëmshme që lidhen me të.

Paragrafi 1.18. fshihet

Paragrafi 1.28. "Qeveria" Qeveria e Republikës së Kosovës;

Paragrafi 1.30. "Ministria" Ministria përgjegjëse për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor.

Paragrafi 1.31. "Ministri" Ministri përgjegjës për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor.

Amendamenti 3

Neni 4, riformulohet si vijon:

1. Burimi i zhurmës është çdo emetues i zërit të padëshirueshëm ose të rrezikshëm si makineria, pajisjet, instalimet, pajisjet për punë dhe transport, operimet teknologjike, pajisjet elektroakustike me nivel të lartë të zërimit etj.

2. Burime e zhurmës në mjedis konsiderohen trafiku rrugor, hekurudhor dhe ajror, duke përfshirë pajisjet për transport dhe infrastrukturë, pajisjet industriale, makineria e punës dhe e ndërtimit si dhe pajisje të tjera të cilat përdoren në hapësira të jashtme në objektet shërbyese.

3. Menaxhimi i pajisjeve akustike në objektet fetare rregullohet në pajtim me aktin nënligjor të cilin e nxjerr Ministria në konsultim me Bashkësit Fetare.

Amendamenti 4

Neni 6, Nënparagrafi 2.3. fjala “**nenit 18**” zëvendësohet me “**nenit 17**”

Nënparagrafi 3.5. ,pas fjales “**paragrafi 3.3**” shtohet “**të këtij neni**”

Amendamenti 5

Neni 21, paragrafi 2, fjala “**nenit 19**” zëvendësohet me “**nenit 20**”

Amendamenti 6

Neni 24, paragrafi 1, fjala “**neni 21**” zëvendësohet me “**neni 22**”

Amendamenti 7

Neni 26, paragrafi 1, fjala “**neni 27**” zëvendësohet me “**neni 28**”

Amendamenti 8

Neni 29, të rishikohet madhësia e gjobave, nga MMPH.

Amendamenti 9

Neni 30, Paragrafi 3. fjala “**dy (2) vjetësh**” bëhet “**6 muaj**”

Amendamenti 10

Neni 31, pas fjalës “**Ligji** “ pjesa tjetër riformulohet si vijon: “**Nr. 02/L-102 për Mbrojtjen nga Zhurma.**”

Mbledhja përfundoi në orën 12,10.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani